



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E KULTURËS

TEATRI KOMBËTAR I OPERAS, BALETIT DHE ANSAMBLIT POPULLOR

Nr. 486 Prot

Datë 08/07/2022

NJOFTIM

Teatri Kombëtar i Operas, Baletit dhe Ansamblit Popullor, në mbështetje të Statutit të Institucionit të TKOBAP miratuar me urdhër të Ministrit të Ministrisë së Kulturës nr 166 datë 27.04.2015; Rregullores së Brendshme të Institucionit; Organikës dhe Strukturës së Institucionit miratuar me Urdhër të Kryeministrit nr 140, datë 28.03.2014 shpall 1 vend vakant për pozicionin e punës: **Specialist Buxhet/ Finance pranë Drejtorisë së Financës dhe Shërbimeve Mbështetës.**

Kandidatët për pozicionin e punës duhet të plotësojnë kërkesat si më poshtë:

- **Specialist Buxhet/ Finance pranë Drejtorisë së Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse**

**Kërkesat e përgjithshme që duhet të plotësojnë personat që aplikojnë:**

1. Të jetë shtetas shqiptar;
2. Të zotërojë gjuhën shqipe të shkruar dhe të folur;
3. Të jetë në kushte shëndetësore që e lejon të kryejë detyrën përkatëse;
4. Të përmbushë kërkesat ligjore për nivelin arsimor dhe të zotërojë aftësitë e nevojshme profesionale për vendin përkatës të punës;
5. Të mos jetë dënuar me vendim të formës së prerë të gjykatës për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundravajtje penale me dashje;
6. Ndaj tij të mos jetë marrë masë disiplinore e largimit nga puna për shkak të një shkeljeje të rëndë disiplinore.

**Kandidatët duhet të plotësojnë kërkesat e posaçme sa vijon:**

1. Të ketë përfunduar studimet e larta në degën Financë/Kontabilitet bachelor + master ose diplomën ekuivalente me to);
2. Të ketë përvojë punë jo më pak se 3 vjet; Preferohen kandidatët me përvojë në Sektorin Shtetëror;
3. Të njohë dhe përdorë shumë mirë programet kompjuterike dhe programet financiare;
4. Të ketë aftësi të mira komunikimi-ndërpersonale, të shkruara dhe verbale si dhe të jetë i/e aftë për të punuar në grup dhe nën presion;
5. Njohja e procedurave të kontabilitetit dhe prokurimeve publike;
6. Të ketë njohuri të gjuhës angleze;
7. Të ketë aftësi të organizojë punën duke përmbushur afatet;
8. Të njohë dhe të zbatojë rregullat e etikës në administratën publike.

## Dokumentacioni, mënyra dhe afati i dorëzimit


1. Jetëshkrimi CV;
2. Fotokopje të diplomës dhe të listës së notave të noterizuara.
3. Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
4. Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
5. Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
6. Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore;
7. Çdo dokument tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive, rekomandime apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin e kandidatit.

Dokumentacioni do të dorëzohet pranë sekretarisë së TKOBAP( zyra e protokollit) ose të skanuara në mailin zyrtar të TKOBAP-së [sekretaria@tkob.gov.al](mailto:sekretaria@tkob.gov.al) deri me datë 25/07/2022. Pas verifikimit të dokumentave të kërkuara, në Teatrin Kombëtar të Operas Baletit dhe Ansamblit Popullor, kandidatët të cilët plotësojnë kriteret e kërkuara do të lajmërohen nepërmjet numrit të tyre të kontaktit ose mail nga Sekretaria e Institucionit, për intervistën e strukturuar me gojë.

Të gjitha njoftimet për shpalljet e vendeve të lira, si dhe data kur do të shpallet fituesi, mund ti gjeni në faqen zyrtare të web-it të Teatrit Kombëtar të Operas Baletit dhe Ansamblit Popullor [www.tkob.gov.al](http://www.tkob.gov.al); faqja zyrtare e Agjensisë së Prokurimit Publik [www.app.gov.al](http://www.app.gov.al).

## DREJTORE e PËRGJITHSHME

Abigeila VOSHTINA



Konceptoi Juriste Migena Billa

